



**Hapet thirrja për mobilitete (bursa) studentësh dhe stafi të UPT-së,
në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus+,
në Vilnius University of Applied Sciences, Vilnius, Lituani.**

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për studentët dhe stafin e Universitetit Politeknik të Tiranës, në Vilnius University of Applied Sciences - VIKO.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime.
- Shkëmbimin e stafit akademik për pjesëmarrje në *International Teaching Week*, (4 – 8 mars 2024).
- Shkëmbimin e stafit administrativ për pjesëmarrje në *International Staff Training Week*, (6 – 10 maj 2024).

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe të kenë përfunduar vitin e parë akademik.

Kohëzgjatja e bursave për studentët: 1 semestër, 5 muaj, (semestri i dytë, i vitit akademik 2023-2024)

Fushat e studimit për studentët: Studentë e interesuar të shohin lëndët që ofrohen nga VIKO, sipas fakulteteve përkatëse, në linkun: <https://en.viko.lt/incoming-students/> (Courses for incoming students).

Numri total i studentëve: 3 studentë

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Listë notash e studimeve deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*;
- Dokumenti Learning Agreement**.

*Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze ku niveli minimal i kërkuar është **B2**. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar gjuhën duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.

***Learning Agreement* është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “*Mobility Plan*”. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.



**Key Action 1
– Mobility for learners and staff –**

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në VIKO lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvillonit lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” te seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, nga Koordinatori Akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për të shkarkuar formatin e “Learning Agreement” klikoni te:

[Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit – Universiteti Politeknik i Tiranës \(upt.edu.al\)](https://upt.edu.al) , aneks 2.

Për t’u njohur me lëndët që ofrohen në RTU, sipas niveleve dhe fushave të studimit, klikoni në link-un: <https://en.viko.lt/incoming-students/>

Afati për aplikim për studentët: Deri më 20 tetor 2023, ora 12.00

Aplikimi për studentët kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT.

Numri total i stafit akademik për pjesëmarrje në *International Teaching Week*, (4 – 8 mars 2024) – **1**

Numri total i stafit administrative për pjesëmarrje në *International Staff Training Week*, (6 – 10 maj 2024) - **1**

Kohëzgjatja e bursave për stafin: 5 + 2 ditë

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Aprovim nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore, ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t’u kryer në universitetin pritës;
- Letra konfirmuese nga universiteti pritës;
- Letër Motivimi;
- Dokumenti Staff Mobility for Teaching/Training;

Për të shkarkuar formatin e “Staff Mobility for Teaching/Training, Mobility Agreement” klikoni te: [Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit – Universiteti Politeknik i Tiranës \(upt.edu.al\)](https://upt.edu.al) , aneks 3/4.

Afati për aplikim për stafin: Deri më 20 tetor 2023, ora 12.00

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT, mund të kontaktoni në e-mail: abeqo@upt.al , rkodra@upt.al